

Plani i Akomodimit sipas Seksionit 504 për Diabetin

Viti Shkollor: _____

Data e Mbledhjes së Ekipit 504: _____

DBN dhe Emri i Shkollës: _____

Informacioni për Nxënësin & Familjen

Emri i Nxënësit: _____ Aftësia e Kufizuar/Diagnoza: _____

Lloji _____ Diabet

OSIS #: _____

DITËLINDJA: _____

Mësuesi i Klasës: _____

Klasa: _____

Emri i Asistentit Personal (nëse aplikohet): _____

Gjuha(t) e Preferuar(a) e Folur dhe e Shkruar nga Prindi/Kujdestari: _____

Anëtarët e Ekipit 504

Shkruani emrin e Koordinatorit 504, të gjithë anëtarëve të Ekipit 504 dhe titujt e tyre.

Emri	Roli
1.	Koordinatori 504
2.	Prindi/Kujdestari
3.	Infermierja e Zyrës së Shëndetit të Shkollës (Office of School Health) (nëse aplikohet)
4.	
5.	
6.	

Objektivat/Qëllimet e këtij Plani

Diabeti mund të shkaktojë nivele të larta ose të ulëta të glukozës (sheqerit) në gjak, të dyja prej të cilave mund të ndikojnë në aftësinë e nxënësit për të mësuar si dhe të rrezikojnë seriozisht shëndetin e nxënësit, si menjëherë ashtu edhe në afat të gjatë. Qëllimi i këtij Plani është të sigurojë ndihmat dhe shërbimet përkatëse si dhe akomodimet e nevojshme për të mbajtur nivelin e glukozës në një interval të sigurt, dhe sa më afër intervalit të synuar të përcaktuar nga ofruesi i kujdesit shëndetësor të licencuar të nxënësit, dhe për të reaguar në mënyrë të përshtatshme ndaj niveleve jashtë këtij intervali në përputhje me udhëzimet e ofruara nga ofruesi i nxënësit.

Koordinatori 504 do të bashkëpunojë me anëtarët e tjerë të Ekipit 504 për të organizuar kujdesin për diabetin e nxënësit në programet dhe aktivitetet e Departamentit të Arsimit të Qytetit të Nju Jorkut (NYC Department of Education - DOE).

Ky Plan do të rishikohet para përfundimit të çdo viti shkollor ose më shpesh nëse është e nevojshme, dhe do të ndryshohet në kohën e rishikimit, nëse është e nevojshme.

Përkufizimet e Përdorura në këtë Plan

Program ose Aktivitet i DOE: Çdo program ose aktivitet i sponsorizuar nga DOE, përfshirë programet pas shkollës ose aktivitetet jashtëshkollore të sponsorizuara nga PA/PTA në një ndërtesë të DOE.

Formulari për Administrimin e Barnave për Diabet dhe Shtesat (DMAF): Formulari i urdhrit të barnave të Zyrës së Shëndetit të Shkollës dhe çdo shtesë që ka të bëjë me regjimin e kujdesit për diabetin, përfshirë nevojat për barna të një

nxënësi me diabet. DMAF dhe çdo shtesë plotësohen nga ofruesi i kujdesit shëndetësor i nxënësit, nënshkruhen nga prindi/kujdestari dhe rishikohen nga Zyra e Shëndetit të Shkollës. Pasi DMAF i nxënësit për vitin shkollor (përfshirë çdo rishikim) të jetë gati për zbatim, Ekipi 504 do të rishikojë këtë Plan dhe do të bëjë çdo ndryshim të nevojshëm për të përputhur me DMAF-in e ri/të rishikuar.

Personeli i Trajnuar Jo i Licencuar (TNP): Personeli jo-mjekësor i shkollës që është trajnuar në njohuritë bazë për diabetin dhe ka marrë trajnim të organizuar nga infermierja e shkollës për kujdesin ndaj diabetit, duke përfshirë njohjen dhe trajtimin e hipoglikemisë, njohjen e hiperglikemisë, matjen e nivelit të glukozës në gjak, administrimin e glukagonit dhe kryerjen e testimit të ketoneve, do të kryejë këto detyra të kujdesit për diabetin në përputhje me ligjet, rregullat dhe udhëzimet në fuqi. Trajnimet përfshijnë edhe referimet e duhura pasuese tek infermierja e shkollës, siç përcaktohet në DMAF. Çdo TNP do të pajiset me një kopje të këtij Plani, me detaje të theksuara mbi shenjat dhe simptomat e hipoglikemisë dhe hiperglikemisë, si dhe rolet e tyre, dhe do të marrë trajnim mbi specifikat e DMAF-it të nxënësit.

1. Ofrimi i Kujdesit për Diabetin

- 1.1. Të paktën _____ anëtarë të stafit do të marrin Trajnim të Nivelit 2 për t'u bërë TNP dhe janë të listuar në Seksionin 2.1. Të paktën _____ anëtarë të stafit do të marrin Trajnim të Nivelit 1 + për Glukagonin dhe janë të listuar në Seksionin 2.4. Një infermiere e shkollës, një infermiere zëvendësuese ose një Infermiere me Kontratë, ose një nga këta anëtarë të trajnuar të stafit, do të jetë i pranishëm në vendin ku ndodhet nxënësi **në çdo moment** gjatë orarit shkollor, gjatë aktiviteteve jashtëshkollore të organizuara nga DOE (Departamenti i Arsimit) dhe gjatë ekskursioneve të organizuara nga DOE, për të ofruar kujdes për diabetin në përputhje me këtë Plan dhe sipas udhëzimeve të dhëna në DMAF.
- 1.2. Infermierja do të kryejë detyrat e mëposhtme të kujdesit për diabetin në përputhje me DMAF-in e nxënësit, dhe do të marrë trajnim për kryerjen e cilësdo prej tyre, nëse është e nevojshme:
 - ☐ përcakton dozën dhe administron insulinën
 - ☐ administron glukagonin nëse është e nevojshme
 - ☐ kontrollon ketonet nëse është e nevojshme, sipas DMAF
 - ☐ mban regjistrat përkatës për administrimin e insulinës dhe trajtime të tjera të glukozës në gjak
 - ☐ komunikon me prindin/kujdestarin lidhur me trajtimin e diabetit
 - ☐ komunikon me ofruesin e kujdesit shëndetësor të nxënësit lidhur me trajtimin e diabetit
 - ☐ komunikon me mjekun e Zyrës së Shëndetit të Shkollës nëse është e nevojshme
 - ☐ bashkëpunon me Drejtorin për të nisur trajnimin e stafit të shkollës
 - ☐ _____
 - ☐ _____
- 1.3. Nëse nxënësi i është caktuar një asistent personal (paraprofesional), ai/ajo do të trajnohet si TNP dhe do të kryejë detyrat e mëposhtme të kujdesit për diabetin në klasë, ose kudo që ndodhet fëmija **[Zgjidhni ato që janë të përshtatshme]**, në maksimumin e mundshëm:
 - ☐ Zbaton Masat Standarde për Kontrollin e Infeksioneve në lidhje me higjienën e duarve, Pajisjet Mbrojtëse Personale (PPE), trajtimin e sigurt të pajisjeve, planifikimin për hedhjen e sigurt të gjilpërave/pajisjeve të mprehta
 - ☐ Kontrollon nivelet e glukozës në gjak me pajisje me shpim gishti
 - ☐ Monitoron leximet në Monitorin e Vazhdueshëm të Glukozës në Gjak (CGM)
 - ☐ Kontrollon ketonet nëse është e nevojshme, sipas DMAF, dhe e referon te infermierja e shkollës **nëse:**
 - ☐ Ketonet janë të moderuara ose të larta
 - ☐ Nxënësi ndjehet keq
 - ☐ Tjetër: _____
 - ☐ Administron glukagon dhe telefonon 911 në rast emergjence dhe mban regjistër përkatës; njofton infermierin dhe administratën e shkollës
 - ☐ Jep glukozë me veprim të shpejtë ose një ushqim në rast hipoglikemie **[Vendosni nga DMAF: glukozë në gjak _____ mg/dL];** njofton infermierin
 - ☐ Jep ujë dhe monitoron në rast hiperglikemie **[Vendosni nga DMAF: glukozë në gjak _____ mg/dL];** njofton infermierin

- ☐ Komunikon me prindin/kujdestarin lidhur me sa më sipër
- ☐ _____
- ☐ _____
- ☐ _____
- ☐ _____

Nëse niveli i glukozës në gjak/sensor të nxënësit, përmes matjes ose CGM, është _____ mg/dL ose më i lartë, asistentja/asistenti personal do t'i japë ujë dhe do ta monitorojë nxënësin, do të kontrollojë ketonet sipas udhëzimeve në DMAF-in e nxënësit dhe do të informojë infermieren e shkollës. Nxënësi në përgjithësi nuk duhet të mbahet në dhomën e mjekësisë për nivele të larta të glukozës në gjak, përveçse nëse ndjehet keq ose është duke marrë trajtim me insulinë.

Sipas shtesës së DMAF-it, nëse CGM është _____ ose më poshtë, ose nëse simptomat nuk përputhen me vlerat dhe/ose shigjetat, asistenti personal mund të kryejë një matje të glukozës në gjak me pajisje për shpim gishti.

Kur asistenti personal i caktuar i nxënësit nuk është i pranishëm, një asistent tjetër me trajnim të përshtatshëm do të ofrojë këtë kujdes për diabetin.

2. Personeli i Trajnuar Jo i Licencuar (TNP)

- 2.1 Anëtarët e mëposhtëm të stafit të shkollës, përfshirë asistentin personal nëse një i tillë është caktuar (shih Seksionin 1.1 më sipër), do të marrin Trajnim të Nivelit 2 për të përmbushur përgjegjësitë e tyre si TNP (shënohen emrat e plotë, titujt dhe datat e trajnimit):

- 2.2 Zyra e Transportit të Nxënësve (Office of Pupil Transportation) siguron që çdo shofer autobusi ose ndihmës autobusi që transporton nxënësin të ketë kryer trajnimin për siguri dhe trajnimin për glukagon, në përputhje me kërkesat përkatëse të Departamentit të Arsimit të Shtetit të Nju Jorkut (New York State Education Department) dhe të DOE.

- 2.3 **Çdo anëtar i stafit që nuk është TNP dhe që është përgjegjës për nxënësin në çdo moment gjatë orarit shkollor, aktiviteteve jashtëshkollore të DOE, ose gjatë ekskursioneve të DOE, do të pajiset me Trajnim të Nivelit 1**, i cili do të përfshijë një përmbledhje të përgjithshme mbi diabetin dhe nevojat tipike të kujdesit shëndetësor të një nxënësi me diabet, njohjen e niveleve të larta dhe të ulëta të glukozës në gjak, dhe si dhe kur të kontaktohet menjëherë infermierja e shkollës ose një TNP.

Anëtarët e stafit që kanë marrë këtë trajnim janë (shënohen emrat e plotë, titujt dhe datat e trajnimit):
[Përfshini mësuesit e Edukimit Fizik dhe trajnerët në këtë listë. Shih Seksionin 5.]

- 2.4 Individët e mëposhtëm që janë ofruar vullnetarisht për t'u trajnuar do të marrin trajnim mbi mënyrën e administrimit të glukagonit, përveç trajnimit të përshkruar në Seksionin 2.3:

3. Niveli i Kujdesit Vetjak të Nxënësit dhe Vendndodhja e Pajisjeve dhe Furnizimeve

3.1 (a) Siç përcaktohet në DMAF:

Niveli i aftësisë së nxënësit për të matur glukozën në gjak është:

- ☐ Infermierja/të rriturit duhet të matin glukozën në gjak
- ☐ Nxënësi do të matë glukozën në gjak nën mbikëqyrjen e një të rrituri
- ☐ Nxënësi mund të matë glukozën në gjak pa mbikëqyrje

Niveli i aftësisë së nxënësit për të administruar vetë insulinën është:

- ☐ Nxënës që varet nga infermierja: infermierja duhet të administrojë medikamentin
- ☐ Nxënës nën mbikëqyrje: nxënësi administron vetë, nën mbikëqyrje të një të rrituri
- ☐ Nxënës i pavarur: Mban/administron vetë, i konfirmuar nga ofrues i licencuar i kujdesit shëndetësor

Niveli i aftësisë së caktuar për orët e shkollës, siç përcaktohet më sipër, duhet të ruhet në çdo kohë dhe në çdo vend në shkollë, gjatë ekskursioneve, në vendet ku zhvillohen aktivitete jashtëshkollore të DOE dhe në autobusët e shkollës.

(b) Nxënësi ka nevojë për një TNP për të kryer ose për të mbikëqyrur detyrat e tjera të kujdesit për diabetin (p.sh., udhëzime verbale gjatë matjes së glukozës ose administrimit të insulinës nga vetë nxënësi, verifikim të saktësisë së llogaritjeve për karbohidratet). Përcaktoni nivelin e pavarësisë për detyrën:

3.2 Nxënësi dhe/ose TNP (duke përfshirë asistentin personal të caktuar) do të lejohen të mbajnë me vete furnizimet dhe pajisjet e mëposhtme për diabetin në çdo kohë dhe në çdo vend (ju lutemi përfshini telefonin dhe/ose orën inteligjente (smart watch) këtu, nëse aplikohet): **[Konsultohuni me DMAF-in dhe infermierin e shkollës për të plotësuar këtë seksion]**

3.3 Furnizimet dhe pajisjet për diabetin që nuk mbahen nga nxënësi dhe furnizime shtesë do të ruhen në: **[Zakonisht në klasë dhe në zonën e infermieres/dhomën mjekësore, ose me TNP (përfshijë pajisjen për monitorimin CGM dhe pajisjet e Menaxhimit Personal të Diabetit) (Personal Diabetes Manager)]**

3.4 Prindi/kujdestari është përgjegjës për të siguruar furnizimet për diabetin dhe ushqimin sipas nevojave të nxënësit, siç është përcaktuar në DMAF.

4. Ushqimet e Lehta (Snacks) dhe Vaktet

4.1 (a) Vaktet dhe ushqimet e lehta do të zhvillohen në përputhje me DMAF.

(b) DMAF përfshin porositë për mëngjes: ☐ Po ☐ Jo

- 4.2 Informacioni mbi përmbajtjen e karbohidrateve për ushqimet dhe vaktet e ofruara nga Zyra e DOE për Shërbime Ushqimore dhe të Ushqyerit (Office of Food and Nutrition Services – OFNS) është i disponueshëm në faqen zyrtare të OFNS ose sipas kërkesës drejtuar Menaxherit të Shërbimit Ushqimor të shkollës në vendngjarje.
- 4.3 Një ushqim i lehtë ose burim me veprim të shpejtë i glukozës duhet të jetë gjithmonë i disponueshëm menjëherë për nxënësin.
- 4.4 Mësuesi do të njoftojë prindin/kujdestarin për çdo ndryshim në orarin e vakteve ose ushqimeve të lehta të paktën 48 orë më parë, ose sa më shpejt të jetë e mundur nëse njoftimi 48-orësh nuk mund të jepet.
- 4.5 Nxënësi do të lejohet të hajë një ushqim të lehtë pavarësisht se ku ndodhet, në kohët e përcaktuara në planin e ushqimeve për nxënësit që varen nga infermierja ose që janë nën mbikëqyrje, kur nxënësi i pavarur e konsideron të përshtatshëm, ose për çdo nxënës sipas nevojës për trajtim. [Shtoni gjuhë shtesë, sipas rastit dhe në përputhje me udhëzimet e prindit/kujdestarit, si për shembull: *Nxënësi duhet të lejohet gjithmonë të konsumojë çdo ushqim që preferon, përfshirë ushqimet e veçanta për raste festash, si për shembull ëmbëlsira/kek. Gjatë kohës së ushqimeve të lehta, ai/ajo duhet të lejohet të zgjedhë midis ushqimit të ofruar nga shkolla dhe atij të sjellë nga shtëpia.*]
- 4.6 Prindi/kujdestari do të sigurojë ushqimet e lehta që janë të nevojshme shtesë ndaj atyre të ofruara për të gjithë nxënësit, ose në vend të tyre.
- 4.7 Prindi/kujdestari do të sigurojë informacion mbi përmbajtjen e karbohidrateve për ushqimet dhe vaktet e sjella nga shtëpia. Nëse prindi/kujdestari nuk ofron këtë informacion, infermierja e shkollës ose TNP do të përdorë një faqe publike për llogaritjen e karbohidrateve.
- 4.8 Ndryshimet në kohët e vakteve dhe ushqimeve të lehta do të lejohen në rast ndryshimesh në orar, sipas kërkesës së prindit/kujdestarit dhe në përputhje me DMAF.

5. Ushtrimet dhe Aktiviteti Fizik

- 5.1 Nxënësi do të lejohet të marrë pjesë plotësisht në orët e edukimit fizik dhe në sportet me ekipe, në përputhje me DMAF-in e nxënësit.
- 5.2 Instruktorët e edukimit fizik dhe trajnerët e sporteve do të marrin trajnim sipas Seksionit 2.3 dhe do të pajisen me një kopje të këtij Plani.
- 5.3 Anëtarët përkatës të stafit të shkollës do të sigurojnë që matësi i glukozës në gjak i nxënësit, një burim glukozë me veprim të shpejtë dhe uji të jenë gjithmonë të disponueshëm në vendin ku zhvillohet ora e edukimit fizik dhe gjatë stërvitjeve apo ndeshjeve të sporteve me ekipe të DOE.

6. Uji, Banjoja dhe Akses në Ashensor

- 6.1 Nxënësi do të lejohet të ketë akses të menjëhershëm në ujë duke mbajtur një shishe uji me vete dhe në bankën e tij/saj, dhe/ose duke u lejuar të përdorë ujin e pijshëm në mjedisin ku ndodhet pa asnjë kufizim.
- 6.2 Nxënësi do të lejohet të përdorë banjën pa kufizim.
- 6.3 Leje për ashensor: Kur është e aplikueshme, stafi i shkollës duhet të sigurojë që nxënësi të ketë akses në ashensor nëse ka nevojë dhe të shoqërohet nga një i rritur kur është e mundur (nxënësve nuk u jepen çelësa/kartela për ashensorin).

7. Matja e Nivelit të Glukozës në Gjak, Administrimi i Insulinës dhe Barnave, dhe Trajtimi i Niveleve të Larta ose të Ulëta të Glukozës në Gjak

- 7.1 Niveli i kujdesit vetjak të nxënësit përcaktohet në seksionin 3 më sipër, duke përfshirë cilat detyra nxënësi mund t'i kryejë vetë dhe cilat duhet të kryhen me ndihmën ose tërësisht nga infermierja e shkollës ose një TNP.
- 7.2 Monitorimi i glukozës në gjak do të bëhet në oraret e përcaktuara në DMAF-in e nxënësit, sa herë që nxënësi ndjen se niveli i glukozës mund të jetë i lartë ose i ulët, ose kur vërehen simptoma të niveleve të larta ose të ulëta të glukozës në gjak. Infermierja(t) ose TNP duhet gjithmonë të minimizojnë kohën që nxënësi mund të humbasë nga mësimi gjatë vendimmarrjes për mënyrën e kryerjes së testimit të glukozës në gjak ose ndihmës për nxënësin në këtë proces, duke pasur si përparësi kujdesin më të përshtatshëm për nxënësin.
- 7.3 Insulina dhe/ose barna të tjera për diabetin do të administrohen në oraret dhe në mënyrën e përcaktuar (p.sh., me shiringë, stilolaps ose pompë) në DMAF-in dhe/ose shtesën përkatëse të nxënësit, si për dozat e planifikuara, ashtu edhe për dozat korrigjuese në rast të niveleve të larta të glukozës. Infermieret duhet gjithmonë të minimizojnë kohën që nxënësi mund të humbasë nga mësimi gjatë vendimmarrjes për administrimin e insulinës, ose, për infermieret dhe TNP, për të ndihmuar nxënësin në administrimin e insulinës, duke pasur si përparësi kujdesin më të përshtatshëm për nxënësin.
- 7.4 Ekipi 504 duhet të diskutojë dhe të përcaktojë mjedisin më pak kufizues për ofrimin e kujdesit ndaj diabetit, bazuar në nevojat individuale të nxënësit dhe jo në burimet e disponueshme. Kujdesi për diabetin mund të ofrohet në klasë ose kudo që ndodhet nxënësi, qoftë në dhomën mjekësore ose në një vend tjetër, me qëllim minimizimin e kohës së humbur nga mësimi dhe maksimizimin e kohës së kaluar me bashkëmoshatarët.

Përcaktoni **vendndodhjen** për secilën detyrë të kujdesit për diabetin:

Insulina në kohën e drekës do të administrohet në _____

Insulina korrigjuese do të administrohet në _____

Insulina gjatë kohës së ushqimit të lehtë do të administrohet në _____

Niveli i glukozës në gjak do të monitorohet në _____

Ketonet do të monitorohen në _____

- 7.5 Nxënësit do t'i sigurohet privatësi gjatë matjes së glukozës në gjak dhe administrimit të insulinës, nëse ai/ajo e kërkon.
- 7.6 Simptomat e zakonshme që nxënësi shfaq në rast të glukozës së lartë në gjak janë:

Simptomat e zakonshme që nxënësi shfaq në rast të glukozës së ulët në gjak janë:

Udhëzimet për mënyrën se si të veprohet në këto raste janë përcaktuar në DMAF.

- 7.7 Kur nxënësi kërkon ndihmë ose ndonjë anëtar i stafit vëren se nxënësi shfaq shenja të niveleve të larta ose të ulëta të glukozës në gjak, anëtari i stafit do të kërkojë menjëherë ndihmë nga infermierja e shkollës ose një TNP, duke u siguruar që një i rritur të qëndrojë me nxënësin gjatë gjithë kohës. Kurrë mos dërgoni diku vetëm një nxënës me nivele të larta ose të ulëta të glukozës në gjak – të konfirmuara ose të dyshuara; sigurohuni që një TNP ose një i rritur ta shoqërojë.

7.8 Nëse nxënësit i bie të fikët, bëhet i pavetëdijshëm:

1. Glukagoni do të administrohet menjëherë nga asistenti personal ose një TNP tjetër, pa kryer matje të glukozës në gjak, dhe duhet të telefononi 911.
2. Kontaktoni infermierin e shkollës ose TNP-në (nëse infermierja nuk është e disponueshme).
3. Asistenti personal, infermierja ose një anëtar tjetër i stafit të shkollës duhet të telefonojë 911 dhe të qëndrojë me nxënësin.
4. Kur nxënësi të rifitojë vetëdijen, duhet të bëhet një matje e glukozës në gjak me shpim gishti, nëse 911 nuk ka mbërritur ende.
5. Kontaktoni zyrën qendrore të shkollës.
6. Kontaktoni prindin/kujdestarin e nxënësit dhe mjekun përmes numrave të emergjencës të dhënë më poshtë.

7.9 Nëse përputhet me urdhrat e DMAF dhe nuk ndërhyr në trajtim, nxënësi mund të kërkojë që stafi i shkollës, përfshirë mësuesit e edukimit fizik dhe trajnerët, të ruajnë pompën e insulinës, nëse nxënësi vendos të mos e mbajë gjatë aktivitetit fizik ose ndonjë aktiviteti tjetër.

8. Transporti, Ekskursionet dhe Aktivitetet Jashtëshkollore

8.1 [Koordinatori 504: zgjidhni njëren nga opsionet e mëposhtme sipas rastit, pas konfirmimit me Koordinatorin e Transportit të shkollës] DOE do të ofrojë sa më poshtë për udhëtimin me autobus të nxënësit drejt dhe nga shkolla çdo ditë:

- ☐ nuk aplikohet (transporti me autobus ("busing") nuk ofrohet);
- ☐ infermiere transporti;
- ☐ asistent personal për transportin;
 - ☐ Ekipi 504 bie dakord që nxënësi mund të udhëtojë me autobus **pa** praninë e një asistenti personal NËSE: detyrat e asistenti personal lidhen **vetëm** me diabetin; **DHE** shoferi/ndihmësi i autobusit janë trajnuar për administrimin e glukagonit.
- ☐ transport "nga trotuari në shkollë" vetëm me ndihmës në autobus;
- ☐ transport "nga stacioni në shkollë" pa ndihmës në autobus.

DHE, e detyrueshme për nxënësit që përdorin autobus: plotësoni [Udhëzuesin e Shpejtë për: Shoferët dhe Ndihmësit e Autobusëve](#).

- 8.2 Nxënësi do të lejohet të marrë pjesë në të gjitha ekskursionet dhe aktivitetet jashtëshkollore të DOE (të tilla si të gjitha aktivitetet pas-shkollore të DOE, sportet, klubet dhe programet e tjera) pa asnjë kufizim dhe me të gjitha akomodimet dhe përshtatjet, përfshirë kujdesin e nevojshëm për diabetin nga personeli i identifikuar i shkollës, siç përcaktohet në këtë Plan. Prindi/kujdestari i nxënësit nuk do të jetë i detyruar, por mund të zgjedhë, që të shoqërojë nxënësin gjatë ekskursioneve ose në ndonjë aktivitet tjetër shkollore.
- 8.3 DOE do të sigurojë një infermiere për të administruar insulinën sipas nevojës, ose personel tjetër të trajnuar për të ofruar të gjithë kujdesin tjetër për diabetin që kërkohet për një nxënë me diabet (përfshirë, por pa u kufizuar në, monitorimin e glukozës në gjak, njohjen dhe trajtimin e hipoglikemisë, ofrimin e ushqimeve të lehta, si dhe aksesin në ujë dhe banjo), sipas kërkesave të përcaktuara në DMAF-in e tyre, për të gjitha ekskursionet dhe aktivitetet jashtëshkollore të DOE, dhe do të sigurohet që furnizimet për diabetin të udhëtojnë me nxënësin gjatë këtyre aktiviteteve. Nëse ky personel nuk është infermierja e shkollës, atëherë infermierja e shkollës do të udhëzojë personelin e caktuar mbi Planin 504 dhe DMAF-in e nxënësit. Nëse infermierja ose anëtar i caktuar i stafit njofton DOE se nuk është i disponueshëm, DOE do të ndërmarrë menjëherë përpjekjet maksimale për të siguruar një zëvendësues (infermier ose anëtar tjetër i trajnuar i stafit). Nëse nuk është i disponueshëm një infermier ose staf i trajnuar, drejtori duhet të shtyjë ekskursionin nëse është e mundur, ose si alternativë e fundit ta anulojë, derisa të mund të organizohet kujdesi i nevojshëm.

- 8.4 Në maksimumin e mundshëm, mësuesi i nxënësit duhet të njoftojë prindin/kujdestarin, drejtorin dhe infermierin e shkollës për çdo ekskursion të planifikuar të paktën 2 javë përpara, në mënyrë që të mund të bëhet kërkesa për infermier shoqërues, dhe të paktën 30 ditë më parë për çdo ekskursion me kohë të zgjatur ose me qëndrim gjatë natës, në mënyrë që të sigurohen dhe rishikohen çdo urdhër shtesë mjekësor dhe të mund të kërket një infermier për udhëtim.
- 8.5 Listoni të gjitha aktivitetet dhe programet e DOE ku nxënësi planifikon të marrë pjesë dhe specifikoni kush do të ofrojë kujdes për diabetin gjatë aktivitetit/programit, çfarë lloj kujdesi për diabetin do të ofrojë ai person, dhe datën kur ai/ajo do të trajnohet ose është trajnuar (p.sh., mëngjesi në shkollë, klubi i shahut, kori):

Programi: _____ Kujdesi i Nevojshëm: _____

Personi që do të ofrojë kujdesin: _____ Data e Trajnimit: _____

Programi: _____ Kujdesi i Nevojshëm: _____

Personi që do të ofrojë kujdesin: _____ Data e Trajnimit: _____

Programi: _____ Kujdesi i Nevojshëm: _____

Personi që do të ofrojë kujdesin: _____ Data e Trajnimit: _____

Programi: _____ Kujdesi i Nevojshëm: _____

Personi që do të ofrojë kujdesin: _____ Data e Trajnimit: _____

- 8.6 Nëse nxënësi po merr pjesë në një program pas-shkollor që nuk është i DOE, prindi mund të kontaktojë Koordinatorin 504 për çdo shqetësim lidhur me aftësinë e programit për të akomoduar diabetin e nxënësit, në përputhje me detyrimet e tyre të pavarura për mosdiskriminim.

9. Akomodimet në Klasë dhe gjatë Testimeve

- 9.1 Nëse nxënësi ndikohet nga nivele të larta ose të ulëta të glukozës në gjak në kohën e testimeve të rregullta ose standarde, ai/ajo do të lejohet ta japë testin në një moment tjetër pa ndëshkim.
- 9.2 Për nxënësit që përdorin CGM, do të zbatohen akomodimet e mëposhtme gjatë testimit **[Shënoni ato që janë të përshtatshme, nëse ka]:**

Nxënësi do të lejohet të përdorë telefonin/orës inteligjente (smart watch) sipas nevojës për kujdesin ndaj diabetit, në përputhje me DMAF-in më të fundit dhe shtesën përkatëse. Mësuesi i klasës ose mbikëqyrësi i testimit do të monitorojë përdorimin e telefonit/orës inteligjente (smart watch) nga nxënësi për të ruajtur integritetin e testit.

☐ Dhomë alternative për testim (për provime mësimore)

☐ Vendorsja e telefonit në një vend të sigurt dhe përdorimi vetëm i pajisjes marrës/orës inteligjente për të monitoruar glukozën në gjak

☐ Shkëputja e telefonit/orës inteligjente nga interneti (p.sh., duke përdorur modalitetin Airplane por duke lejuar Bluetooth) për të lejuar nxënësin të vazhdojë të përdorë telefonin/orën për të monitoruar glukozën

☐ _____

☐ _____

☐ _____

☐ _____

- 9.3 Nëse nxënësi ka nevojë të bëjë pushime për të pirë ujë ose përdorur banjon, për të matur glukozën në gjak, ose për të trajtuar hipoglikeminë ose hiperglikeminë gjatë një testi apo aktiviteti tjetër, atij/asaj do t'i jepet kohë shtesë sipas nevojës për të përfunduar testin ose aktivitetin tjetër pa ndëshkim.
- 9.4 Nxënësit do t'i jepet mësim mbështetës për të rikuperuar çdo pjesë të humbur të orës për shkak të kujdesit për diabetin pa ndëshkim.
- 9.5 Mungesat për shkak të takimeve mjekësore dhe/ose për shkak të sëmundjes do të justifikohen. Prindi/kujdestari do të sigurojë dokumentacion nga profesionisti mjekësor që trajton nxënësin, nëse kërkohet ndryshe nga rregullorja e shkollës.

10. Komunikimi

- 10.1 Infermierja e shkollës, TNP dhe stafi tjetër do të mbajnë konfidenciale të gjitha informacionet që lidhen me diabetin e nxënësit, në përputhje me ligjet, rregullat dhe udhëzimet përkatëse.
- 10.2 Inkurajimi është thelbësor. Nxënësi duhet të trajtohet në një mënyrë që e inkurajon të hajë në kohë dhe të përparojë drejt kujdesit të pavarur, në bashkëpunim me endokrinologun dhe familjen e tij/saj.
- 10.3 Mësuesi ose TNP do të njoftojnë me kohë prindin/kujdestarin dhe infermierin për çdo ndryshim të planifikuar në aktivitete, si: ushtrime fizike, kohë në këndin e lojërave, ekskursione, festa ose orar dreke, në mënyrë që të bëhen përshtatjet e nevojshme në planin e drekës, ushqimeve të lehta dhe dozës së insulinës.
- 10.4 Çdo infermiere zëvendësuese ose Infermiere me Kontratë që punon me nxënësin do të pajiset me udhëzime të shkruara mbi kujdesin për diabetin dhe një kopje të DMAF-it dhe të këtij Plani. Çdo mësues zëvendësues që punon me nxënësin do të pajiset me informacion mbi kujdesin ndaj diabetit të nxënësit dhe mbi mënyrën dhe kohën kur duhet të kontaktohet menjëherë infermierja e shkollës ose një TNP.
- 10.5 Kur dorëzohet një DMAF i ri, prindi/kujdestari do të njoftojë infermierin e shkollës për çdo ndryshim në trajtimin, pajisjet dhe/ose furnizimet për diabetin.
- 10.6 TNP do të njoftojë infermierin për të gjitha matjet e glukozës dhe trajtimet gjatë ditës shkollore dhe do t'i dorëzojë infermieres dokumentacionin e të gjitha veprimeve të ndërmarra për kujdesin ndaj diabetit deri në fund të ditës shkollore, për t'u përfshirë në kartelën mjekësore të nxënësit.

11. Evakuimi Emergjent dhe Qëndrimi në Vend (Shelter-In-Place)

- 11.1 Në rast të një evakuimi emergjent ose situatë që kërkon qëndrimin në vend, Plani 504 i nxënësit dhe DMAF-i do të mbeten plotësisht në fuqi.
- 11.2 Infermierja e shkollës ose TNP do të ofrojë kujdes për diabetin ndaj nxënësit sipas këtij Plani dhe DMAF-it të nxënësit, do të jetë përgjegjëse për transportimin e furnizimeve dhe pajisjeve të diabetit të nxënësit, do të përpiqet të vendosë kontakt me prindin/kujdestarin dhe të ofrojë përditësime, si dhe do të marrë informacion nga prindi/kujdestari lidhur me kujdesin për diabetin e nxënësit. Infermierja e shkollës gjithashtu do të marrë dhe përcjellë informacionin te ofruesi mjekësor i nxënësit, sipas rastit.

12. Njoftimi i Prindit/Kujdestarit

12.1 Njoftoni prindin/kujdestarin në rastet e mëposhtme::

- Simptomat e niveleve shumë të ulëta të glukozës në gjak [Vendosni simptomat specifike të hipoglikemisë së rëndë për këtë nxënës]:
- Rezultatet e testit të glukozës në gjak të nxënësit janë nën _____ ose janë nën _____ 15 minuta pasi ka konsumuar lëng frutash ose tableta glukoze.
- Shenjat dhe simptomat e niveleve shumë të larta të glukozës në gjak [Vendosni simptomat specifike të hiperglikemisë së rëndë për këtë nxënës]: _____
- Prindi/kujdestari dëshiron të kontaktohet në rast se (niveli i glukozës në gjak/sensor) është mbi _____ dhe për rezultatet e testimit të ketoneve. (Trajtimi duhet të bëhet në përputhje me DMAF-in).
- Nxënësi refuzon të hajë ose të bëjë injeksionin/dozën e insulinës.
- Çdo lëndim.
- Probleme me funksionimin e pompës së insulinës, pavarësisht nëse problemi është zgjidhur apo jo
- Përdorimi i mënyrës rezervë për administrimin e insulinës pas mosfunksionimit të pompës
- Tjetër

13. Udhëzime për Kontakt në Rast Emergjence

Telefononi prindin/kujdestarin në numrat e listuar më poshtë. Nëse nuk është e mundur të kontaktoni prindin/kujdestarin, telefononi kontaktet e tjera për raste emergjente ose ofruesit e kujdesit shëndetësor të nxënësit të listuar më poshtë.

Kontaktet Emergjente

Prind(ërit)/Kujdestar(ët)

Kontakti 1

Emri: _____

Celular: _____

Telefoni i Shtëpisë: _____

Telefoni i Punës: _____

Kontakti 2

Emri: _____

Celular: _____

Telefoni i Shtëpisë: _____

Telefoni i Punës: _____

Kontaktet e Tjera për Emergjencë

Kontakti 1

Emri: _____

Celular: _____

Telefoni i Shtëpisë: _____

Telefoni i Punës: _____

Kontakti 2

Emri: _____

Celular: _____

Telefoni i Shtëpisë: _____

Telefoni i Punës: _____

Ofruesi(t) i Kujdesit Shëndetësor të Nxënësit

Emri: _____

Celular: _____

Telefoni i Shtëpisë: _____

Telefoni i Punës: _____

Nënshkrimet

Unë kam marrë [Njoftimin e DOE për Mosdiskriminim sipas Seksionit 504](#) dhe Njoftimin për Përcaktimin e Përshtatshmërisë. Me anë të këtij nënshkrimi, jap pëlqimin tim për ofrimin e akomodimeve për fëmijën tim, siç është përshkruar më sipër.

Aprovuar dhe Marrë

Nënshkrimi i Prindit/Kujdestarit: _____

Data: _____

Aprovuar dhe Marrë

Nënshkrimi i Administratorit të Shkollës: _____

Titulli: _____

Data: _____

Nënshkrimi i Infermieres së Zyrës së Shëndetit të Shkollës (nëse aplikohet): _____

Data: _____

ADMINISTRATIVE USE ONLY / VETËM PËR PËRDORIM ADMINISTRATIV

Notes on Services Requested But Not Approved (Notes from the 504 Coordinator)

Notes on Accommodations Offered but Not Authorized by Parent (Notes from the 504 Coordinator)

Supporting Documentation

Has compliance information and the following documentation been submitted to the online 504 Data Tracker?

- ☐ 504 Accommodation Request Forms
- ☐ [Notice of Non-Discrimination under Section 504](#)
- ☐ Notice of Eligibility Determination
- ☐ 504 Meeting Attendance Sheet
- ☐ Signed 504 Plan

Has the 504 information also been entered into the ATS S504 screen?

Health Director Approval

(If a funded service is authorized by your Health Director)

ASHR Form ID: _____